5

**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr.______datë____/____/2025**

## MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN ZNJ.TEFTA SELMANI.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social", VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", vendim nr. 518, datë 03.10.2018 "Për proçedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social".

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerën znj.Tefta Selmani, në shumën 44.000 (dyzete e katër mijë mijë) lekë.

2. Shuma prej 44.000 (dyzetë e katër mijë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.

3. Pagesa do të bëhet për llogari të kërkuesit z.Novrus Selmani, bashkëngjitur fatura tatimore.

Adresa:Blvd. "Republika 2", Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935, Website: www..bashkiaberat.gov.al, Email : bashkiaberat@yahoo.com

4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Financës dhe drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**
Evisa ÇELA

Këshilli Bashkiak e miratoi me: ___ Vota Pro, ___ Vota Kundër, ___ Vota Abstenim

6

**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr.______datë____/____/2025**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE PËR RASTE TË VEÇANTA ZNJ.MILIKA PRIFTI.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.____.2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social", VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", vendim nr. 518, datë 03.10.2018 "Për proçedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social".

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për znj.Milika Prifti, në shumën 40.000 (dyzet mijë mijë) lekë.

2. Shuma prej 40.000 (dyzet mijë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.

3. Pagesa do të bëhet për llogari të kërkuesit z.Veli Prifti bashkëngjitur fatura tatimore.

4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Financës dhe drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**
Evisa ÇELA

Këshilli Bashkiak e miratoi me: ___ Vota Pro, ___ Vota Kundër, ___ Vota Abstenim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# PROJEKTVENDIM

**Nr. ______, datë __________2025**

## MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z.ARMANDO SHKURTI

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin"; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e e bonusit të qirasë për familjen e Z.Armando Shkurti për periudhën 01.10.2025 - 31.12.2025 në vlerën 51,000 lekë.

2. Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Evisa ÇELA**

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

# PROJEKT-VENDIM

# PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2026 DHE PBA PËRFUNDIMTARE 2026-2028

Këshilli Bashkiak Berat pasi u njoh me materialin e përgatitur nga Grupi i Manaxhimit Strategjik të Bashkisë Berat "Relacion mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028", në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8, 9, 41, 54/dh, 64/c, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, pika ç, d, 39,40 41, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar , ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 65, pika 1, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", ligjit 93/2024 "Për një ndryshim në ligjin nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e adminsitratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë minimale", Vendimin nr. 422, datë 26.06.2024 "Për disa ndryshime ne vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 28.12.2021, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Berat", i ndryshuar, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", I ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8 datë 28.02.2025 " Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028", Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 "Për përgatitjen e PBA Vendor 2026-2028", dhe shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 15876 datë 06.11.2025 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026", me propozim të Kryetarit të Bashkisë

## VENDOSI :

1. Miratimin e treguesve të buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Berat për periudhën 2026 - 2028 si më poshtë :

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë Berat për periudhën 2026 - 2028, në vlerat si më poshtë:

Vlerat paraqiten në: ALL

| Lloji i të Ardhurave | | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Plani | Plani |
| **A** | **Të Ardhura nga Burimet e Veta** | **646,483,000** | **651,975,000** | **656,747,000** |
| A.1 | Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore | 582,809,000 | 586,391,000 | 589,195,000 |
| A.2 | Të Ardhurat nga Taksat e Ndara | 63,674,000 | 65,584,000 | 67,552,000 |
| **B** | **Transferta nga Buxheti Qendror** | **1,012,830,674** | **1,051,942,559** | **1,086,804,887** |
| B.1 | Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme (përfshirë transf.për rritjen e pagave) | 611,514,899 | 650,626,784 | 685,489,112 |
| B.2 | Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale | 401,315,775 | 401,315,775 | 401,315,775 |
| **C** | **Grante të Huaja** | **3,505,918** | **6,889,654** | **650,781** |
| C.1 | Grante të Huaja | 3,505,918 | 6,889,654 | 650,781 |
| | **Total të ardhura/burime buxhetore (A+B+C)** | **1,662,819,592** | **1,710,807,213** | **1,744,202,668** |

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe periudhën 2026 – 2028 , në vlerat si më poshtë:

Vlerat paraqiten në: ALL

| Kategoria e Shpenzimeve | | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Plani | Plani |
| 1 | Shpenzime Personeli (600-601) | 956,572,000 | 966,136,000 | 975,800,000 |
| 2 | Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 506,971,191 | 530,715,191 | 543,108,441 |
| 3 | Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 195,770,483 | 207,066,368 | 224,643,446 |
| 4 | Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja) | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja) | 3,505,918 | 6,889,654 | 650,781 |
| 6 | Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja) | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali i Shpenzimeve** | **1,662,819,592** | **1,710,807,213** | **1,744,202,668** |

7

2. Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, sipas Tabelave të Buxhetit Vjetor 2026, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e raporteve të buxhetit afatmesëm 2026-2028, sipas Tabelave të PBA 2026-2028, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Miratimin e numrit total të punonjësve për vitin 2026 të bashkisë Berat : 816 punonjës për 6 njësi shpenzuese, nga të cilët numri i strukturës së Policisë Bashkiake është 17, sipas listës së njësive shpenzuese, tabela pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit bashkiak në masën 10 % të pagës së kryetarit të bashkisë.
6. Miratimin e shpërblimit mujor të kryetarëve të fshatrave në masën 6 % të pagës së kryetarit të Bashkisë.
7. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit artistiko-kulturor me 4,500 lekë çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje. sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
8. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të Grupit të këngës popullore , të Orkestrës Simfonike, të Bandës Frymore, në Qendrën Kulturore "Margarita Tutulani" me 7,000 lekë/muaj.
9. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të Asamblit të Valles, të Artit Skenik , në Qendrën Kulturore "Margarita Tutulani" me 5,000 lekë/muaj.
10. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të depozitojë pranë Degës së Thesarit Berat buxhetin e vitit 2026 të detajuar sipas udhëzimeve përkatëse.
11. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë e bashkisë Berat dhe njësitë shpenzuese në varësi të saj.
12. Vendimi hyn në fuqi në datën 1 janar 2026.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Evisa ÇELA**

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**KËSHILLI BASHKIAK**

# PROJEKT –VENDIM
# "PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029"

Këshilli Bashkiak Berat pasi u njoh me materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029" , bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 pika dh, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 33, 34, 35 36, 37, 38, 39. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise; me ndryshimet e bëra, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018" Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde te përgatitje s se Programit Buxhetor Afatmesëm", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, :

## VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin "Për procedurat standarte për pregatitjen e kërkesave të programit buxhetor afatmesëm 2027 -2029" sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Berat
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Evisa ÇELA**

**KALENDARI I AKTIVITETEVE TË HARTIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027 - 2029**

| PERIUDHA | DATA | INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS | VEPRIMI PERKATES |
|---|---|---|---|
| Dhjetor 2025 | Brenda muajt dhjetor | Kryetari i NJQV-së | Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm |
| 2025 | Deri - 31 Dhjetor | Këshilli i Njësisë Vendore | Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm |
| Janar 2026 | 15 | Kryetari i NJQV-së | Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese |
| Janar 2026 | 31 | Kryetari i NJQV-së | Kryetari i njësisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlerEsimit të të ardhurave dhe shpenzimeve |
| Mars 2026 | 1 | Këshilli i Njësisë Vendore | Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve |
| Mars 2026 | Brenda dates 15 | Kryetari i NJQV-së | Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA |
| Mars 2026 | 15 | Këshilli i Njësisë Vendore | Miraton tavanet përgatitore të shpnenzimeve të programit buxhetor afatmesëm |
| Mars 2026 | 20 | Kryetari i NJQV-së | Miraton udhezimin e pergatitjes se buxhetit të njesise vendore dhe e shperndan tek njesite shpenzuese |
| Mars - Prill 2026 | 21 Mars -25 Prill | Njesite shpenzuese të bashkisë | Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore |
| Mars - Prill 2026 | 26 Prill - 27 Prill | Njësia e vetëqeverisjes vendore | Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2026-2028 |
| Mars - Prill 2026 | 28 Prill - 30 Prill | Njësitë shpenzuese të Bashkisë | Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura |
| Maj 2026 | 1 Maj - 15 Maj | Njësia përgjegjëse për buxhetin në | Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore |
| Maj 2026 | 16 Maj - 26 Maj | Kryetari i NJQV-së | Organizon seancat dëgjimore me Banorët |
| Maj 2026 | 27 Maj - 29 Maj | Kryetari i NJQV-së | Prezanton dokumentin e PBA 2026-2028 me shoqërinë civile |
| Maj 2026 | 30 Maj - 31 Maj | Njësia përgjegjëse për buxhetin në | Perpilon draftin e fazes së parë të PBA-së 2026-2028 |
| Qershor 2026 | 1 | Kryetari i NJQV-së | Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm |
| Qershor 2026 | Deri - 20 | Ministria e Financave | Dërgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm |
| Qershor 2026 | Deri -25 | Njësia përgjegjëse për buxhetin në | Reflekton komentet e Ministrisë së Financave |
| Qershor 2026 | Deri - 30 | Këshilli i Njësisë Vendore | Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm |
| Korrik 2026 | Deri - 5 Korrik | Kryetari i NJQV-së | Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm |
| Korrik 2026 | Deri - 20 Korrik | Këshilli i Njësisë Vendore | Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm |
| Korrik 2026 | 25 | Kryetari i NJQV-së | Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese |
| Korrik - Gusht 2026 | 26 Korrik-31 Gusht | Njësitë shpenzuese të bashkisë | Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare. |
| Shtator 2026 | 1 | Njësitë shpenzuese të bashkisë | Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat buxhetoretë rishikuara |
| Shtator 2026 | 2 Shtator - 14 Shtator | Njësia përgjegjëse për buxhetin në | Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore |
| Shtator 2026 | Deri - 15 Shtator | Kryetari i NJQV-së | Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar |
| Shtator-Tetor 2026 | Deri 5 Tetor | Ministria e Financave | Organizohen seanca konsultimi me njësite e veteqeverijses vendore |
| Tetor 2026 | Deri - 20 Tetor | Ministria e Financave | Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA |
| Tetor-Nentor 2026 | 6 Tetor -30 Nentor | Njësia përgjegjëse për buxhetin në | Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2026 si dhe, dokumentin perfundimtar të PBA 2026-2028 dhe i paraqet për shqyrtim ne KB |
| Dhjetor 2026 | 26 | Këshilli i njësisë vendore | Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor |
| Dhjetor 2026 | 31 | Kryetari i NJQV-së | Merr masat për publikimin e dokumentint te plotë të programit buxhetor afatmesëm |

2

**R E P U B L I K A   E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA BERAT**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.______prot. Berat ,më___,____2025

# PROJEKT-VENDIM

## Nr._____ datë. ________

## "Për miratimin e planit të punës të Këshillit Bashkiak Berat për vitin 2026"

Kryesia e Këshillit Bashkiak Berat, në bashkëpunim me komisionet e përhershme që funksionojnë në Këshill ka hartuar "Planin e aktivitetit të Këshillit Bashkiak Berat " në zbatim të ligjit Nr 139/2015 Për vetqeverisjen Vendore "i ndryshuar, Vkb nr. 5 Dt 30.01.2020 "Per forcimin e organizimit dhe funksionimit te Keshillit bashkiak Berat, Vkb nr. 26 dhe 27 te dates 23.04.2020 Per miratimin e Rregullores se Shqurtimit te kerkesave ankesave, peticioneve, dhe Iniciativave qytetare, Rregullores se Funskinimit te Strukturave Komunitare dhe nderveprimi i tyre me Keshillin bashkiak, Rregullores se Keshillit bashkiak per Konsultimet publike dhe marredhenies me median me propozim te Kryetarit te Keshillit:

**VENDOSI :**

1. Miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Berat për vitin 2026,sipas dokumentit (Plani vjetor i punes, Plani i konsultimeve publike dhe Buxheti I Keshillit ose shpenzimet) bashkëlidhur te cilat jane pjese e ketij vendimi)
2. Ngarkohet Keshilli bashkiak, Kryetari i Bashkise, Sekretari I Keshillit per zbatimin e ketij Vendimi
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas pikes 6 nenit 55 te ligjit 139/2015 'Per Vetqeverisjen Vendore' I ndryshuar.

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK**

**EVISA ÇELA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BERAT

# PLAN-KALENDAR VJETOR KESHILLI BASHKIAK BERAT 2026

| Muaji | FUSHA VENDORE | DETYRIM LIGJOR PER | KOMISIONI I KB | NEVOJA PER ASISTENCE | NDERLDHJA ME DOKUMENTE STRATEGJIK TE MIRATUAR |
|---|---|---|---|---|---|
| Janar | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Plani Social Dhe i Mbrojtjes Së Fëmijëve: Vlerësimi i progresit dhe rishikimi i veprimeve të parashikuara në periudhën 2020-2021. Strehimi social (parashikuar ne PBA) | | Komisioni i Barazise Gjinore dhe Perfshirjes Sociale | asistence/konsulence | Plani Social miratuar me VKB |
| | Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, jo me vone se 31 janari | | | | ligj nr.68/2017 |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| Shkurt | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Vizite studimore ne Kosove per keshilltaret | | | | |
| | Ndertimi i regjistrit te kerkesave per vendimet e Keshillit Bashkiak | | | | ligj nr.146/2014 nr.139/2015 |
| | Pjesemarrje ne trajnime per Sekretariatin e KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| Mars | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Miratimi i raportit te vleresimit te te ardhurave dhe shpenzimeve | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | LIGJ NR.68/2017 |
| | Shqyrtim i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi | | | | LIGJ NR.68/2017 |
| | Marrja e informacionit ne fushen financiare nga auditi I brendshem ose nga KLSH | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Vizite studimore ne NjQV brenda vendit | | | | |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Prill | Ndryshim buxheti | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB+ligji specifik |
| | Perfundimi dhe modernizimi i furnizimit me uje (PPV) | | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| Maj | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Paraqitja e raportit per akivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor te vitit paraardhes I cili duhet te jete i krahasueshem me planin e buxhetit vjetor | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB+ligji specifik |
| | Analize e punes se ndermarrjes ne varesi Ujesjelles Kanalizime Diber | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise; Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| | Pjesemarrje ne trajnime per Sekretariatin e KB | | | | |
| | Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret | | | | ligj nr.139/2015 + Rreg KB |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Miratimi fazes I te PBA, duke shprehur edhe opinionin e tij per rekomandimet e Ministrise se Financave | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2017 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Qershor | Monitorimi i zbatimit te buxhetit 4-mujor | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2018 |
| | Rishikim buxhetit | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2019 |
| | Zhvillimi i transportit publik dhe i sistemit te shkembimit intermodal (PPV) | degjese publike me komunitetin | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| | Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhenia e keshillit | | | | ligj nr.139/2015 |
| | Ceremoni per dhenie tituj nderi | | | | ligj nr.139/2015 |
| Korrik | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Miartim i tavaneve perfundimtare te PBA | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.68/2017 |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2019 |
| | Marrje informacioni mbi procesin e certifikimit te pronave bujqesore ne NjA | Po | omision i perbashket | | PPV |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gusht** | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Efikasiteti i energjise ne ndertesat publike dhe private | | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| **Shtator** | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Vizite studimore jashte vendit | | | | |
| | Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret | | | | |
| **Tetor** | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Monitorimi i realizmit te 8-mujorit | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Pjesemarrje ne festa lokale | | | | Ligj nr.139/2015 |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| **Nentor** | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| Dhjetor | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | ligj nr.139/2015, Rreg KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | ligj nr.139/2015, Rreg KB |
| | Miratimi i buxhetit vjetor dhe PBA | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Miratim i sistemit fiskal | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2018 |
| | Ceremoni per dhenie tituj nderi | | | | ligj I posaçem |
| | Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhenia e keshillit | | | | ligj nr.139/2015 |

Planifikimi i nje fondi kontigjence per nevoja qe mund te jene te paplanifikuara ne kete plan

KRYETARI I KESHILLIT
EVISA ÇELA

# PLAN-KALENDAR VJETOR KESHILLI BASHKIAK BERAT 2026

| Muaji | FUSHA VENDORE | DETYRIM LIGJOR PER | KOMISIONI I KB | NEVOJA PER ASISTENCE | NDERLDHJA ME DOKUMENTE STRATEGJIK TE MIRATUAR |
|---|---|---|---|---|---|
| Janar | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Plani Social Dhe i Mbrojtjes Së Fëmijëve: Vlerësimi i progresit dhe rishikimi i veprimeve të parashikuara në periudhën 2020-2021. Strehimi social (parashikuar ne PBA) | | Komisioni i Barazise Gjinore dhe Perfshirjes Sociale | asistence/konsulence | Plani Social miratuar me VKB |
| | Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, jo me vone se 31 janari | | | | ligj nr.68/2017 |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| Shkurt | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Vizite studimore ne Kosove per keshilltaret | | | | |
| | Ndertimi i regjistrit te kerkesave per vendimet e Keshillit Bashkiak | | | | ligj nr.146/2014 nr.139/2015 |
| | Pjesemarrje ne trajnime per Sekretariatin e KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| Mars | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Miratimi i raportit te vleresimit te te ardhurave dhe shpenzimeve | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | LIGJ NR.68/2017 |
| | Shqyrtim i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi | | | | LIGJ NR.68/2017 |
| | Marrja e informacionit ne fushen financiare nga auditi I brendshem ose nga KLSH | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Vizite studimore ne NjQV brenda vendit | | | | |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Prill** | Ndryshim buxheti | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB+ligji specifik** |
| | Perfundimi dhe modernizimi i furnizimit me uje (PPV) | | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| **Maj** | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Paraqitja e raportit per akivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor te vitit paraardhes I cili duhet te jete i krahasueshem me planin e buxhetit vjetor | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB+ligji specifik** |
| | Analize e punes se ndermarrjes ne varesi Ujesjelles Kanalizime Diber | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise; Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| | Pjesemarrje ne trajnime per Sekretariatin e KB | | | | |
| | Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret | | | | ligj nr.139/2015 + Rreg KB |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | **Ligj nr.139/2015, Rreg.KB** |
| | Miratimi fazes I te PBA, duke shprehur edhe opinionin e tij per rekomandimet e Ministrise se Financave | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2017 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Qershor | Monitorimi i zbatimit te buxhetit 4-mujor | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2018 |
| | Rishikim buxhetit | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2019 |
| | Zhvillimi i transportit publik dhe i sistemit te shkembimit intermodal (PPV) | degjese publike me komunitetin | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| | Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhenia e keshillit | | | | ligj nr.139/2015 |
| | Ceremoni per dhenie tituj nderi | | | | ligj nr.139/2015 |
| Korrik | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Miartim i tavaneve perfundimtare te PBA | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.68/2017 |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | ligj nr.139/2015+nr.68/2019 |
| | Marrje informacioni mbi procesin e certifikimit te pronave bujqesore ne NjA | Po | omision i perbashket | | PPV |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gusht | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Efikasiteti i energjise ne ndertesat publike dhe private | | Komisioni i Sherbimeve Publike, Strehimit dhe Rregullimit te Territorit | asistence/konsulence | PPV |
| Shtator | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Vizite studimore jashte vendit | | | | |
| | Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret | | | | |
| Tetor | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Ndryshim buxheti | Po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Monitorimi i realizmit te 8-mujorit | | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Pjesemarrje ne festa lokale | | | | Ligj nr.139/2015 |
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| Nentor | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | Ligj nr.139/2015, Rreg.KB |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete me interes per KB | | | | |
| Dhjetor | Mbledhje e Keshillit Bashkiak | | | | ligj nr.139/2015, Rreg KB |
| | Mbledhje e Komisioneve te Perhershme te KB | | | | ligj nr.139/2015, Rreg KB |
| | Miratimi i buxhetit vjetor dhe PBA | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2017 |
| | Miratim i sistemit fiskal | po | Komisioni i Kontrollit te Brendshem Financiar dhe Ekonomise | | Ligj nr.139/2015 + nr.68/2018 |
| | Ceremoni per dhenie tituj nderi | | | | ligj I posaçem |
| | Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhenia e keshillit | | | | ligj nr.139/2015 |

Planifikimi i nje fondi kontigjence per nevoja qe mund te jene te paplanifikuara ne kete plan

KRYETARI I KESHILLIT
EVISA ÇELA

14

**Keshilli BashkiakBERAT**
**BUXHETI VJETOR -draft**

| Nr | Emertimi i Shpenzimeve | Numri | Plan 2026 |
|---|---|---|---|
| a. | **Shpenzime personeli për këshillin** | 31 | 19,081 |
| 1 | Shpërblim për Këshillin (1/10 e pagës së kryetarit)(Honorare) | 31 | 9,486 |
| 2 | Sekretari i Këshillit(paga +sigurime shoqërore) | 1 | 1,889 |
| 3 | Specialist i Këshillit (paga +sigurime shoqërore) | 1 | 1,096 |
| 4 | Shpërblim për Kryetarët e Fshatrave | 36 | 6,610 |
| b. | **Shpenzime Operative (sipas planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për 2026) (Artikulli 602)** | | 520 |
| 1 | Shpenzime për konsultime (seance konsultimi me bashkësinë, dëgjesat publike, transparenca e informimit) | | 75 |
| 2 | Shpenzime për dhurata ceremoniale (buqeta lulesh, kurora,) | | 64 |
| 3 | Blerje çertifikata, karta, kartolina urimi për festat zyrtare | | 18 |
| 4 | Shpenzime për mirëmbajtje pajisje kompjuterike | | 60 |
| 5 | Kancelari zyre | | 103 |
| 6 | Shpenzime per aleancen e grave keshilltare dhe nisma me baze ligjore | | 200 |
| Totali i Shpenzime (a + b) | | | 19,601 |